

# Duke Ndërtuar në Mënyrë Kronologjike në Fushën e Evangjelizmit

Duke i kuptuar gjithnjë e më shumë parimet biblike për mësimdhënien e Shkrimeve të Shenjta, mu shtua edhe më shumë dëshira për t'i vënë në praktikë me anë të punës evangjeliste në një zonë të re në Palavano, që akoma nuk ishte prekur nga Ungjilli. Në vitin 1962, Zoti përdori ambicien e Palit, *"Po, kështu unë jam përpjekur të predikoj ungjillin, atje ku nuk ishte i njohur emri i Krishtit, që të mos ndërtoj mbi themelet e tjetrit."* (Romakët 15:20), për të më detyruar mua të lë punën misionare në Australi dhe të shkoj në komunitetet fisnore në Filipine ku nuk ishte predikuar më parë Ungjilli. Edhe një herë Zoti përdori këtë varg për të më çuar në një zonë në Palavano që ishte pa dëshmitarë të Ungjillit. Ndërsa po përgatitesha të filloja këtë punë të re më në jug, mbas disa vitesh, zbulova që metodat dhe mënyra e mësimdhënies sime kishte krijuar të njëjtin keqkuptim të Ungjillit, sinkretizëm, legalizëm, dhe themele të papërshtatshme të Testamentit të Vjetër për të kuptuar Testamentin e Ri me të cilin ishte përpjekur për kaq vite me rradhë midis kishave palavane. Cili ishte ai element që duhej përfshirë në programin tim të mësimdhënies evangjeliste në mënyrë që të parandalohet ky keqkuptim?

Tani për mua ishte e qartë se, kur predikohet ungjilli, ne duhet të ndjekim udhëzimet mësimdhënëse të demonstruara në Shkrimet e Shenjta. Këto parime të mësimdhënies janë diskutuar në kapitujt e mëparshëm. Më poshtë po japim një përmbledhje të shkurtër për të marrë parasysh arsyen logjike dhe biblike për programin mësimdhënës që po parashtroj:

1. Shkrimet e Shenjta që shpjegohen në punën evangjeliste duhet t'u tregojnë dëgjuesve tanë zbulimin e natyrës dhe të karakterit të Perëndisë në mënyrë që t'i përgatisin për Ungjillin. Kur predikohet Ungjilli, ne më parë duhet të shpjegojmë shenjtërinë, drejtësinë dhe zemërimin e Perëndisë kundër mëkatarëve në mënyrë që njerëzit të gjykojnë

vetë nga ana e tyre në dritën e konceptit biblik për Perëndinë.

2. Meqë Perëndia ka vendosur që ta zbulojë veten e Tij nëpërmjet akteve të Tij në histori dhe jo thjesht me anë të deklaratave dhe parashtresave, mësimdhënia jonë evangjeliste duhet të përfshijë pjesët historike të Shkrimeve të Shenjta ku Perëndia e zbulon natyrën dhe karakterin e Tij të vërtetë.

Mënyra  
më e mirë për të  
predikuar  
Ungjillin është të  
fillosh nga fillimi  
dhe të shpjegosh  
Shkrimet e Shenjta  
në mënyrë  
kronologjike.

3. Ligji duhet të jetë pjesë e mësimdhënies sonë kur ne përgatisim zemrat e dëgjuesve tanë për t'i besuar vetëm Krishtit, sepse "...me anë të ligjit arrihet njohja e mëkatit." (Romakët 3:20). Nëse duam të evitojmë sinkretizmin, legalizmin dhe kombinimin vepra-hir, ne duhet ta përdorim ligjin siç duhet në mënyrë që ndërgjegjia e dëgjuesve tanë të ballafaqohet me fuqinë bindëse dhe provuese të Ligjit.

4. Qëllimi i të gjithë evangjelizmit të vërtetë është t'i shohë njerëzit duke i besuar vetëm Zotit Jezus Krisht dhe veprës së Tij shpëtuese në emër të tyre. Nëse duam që dëgjuesit tanë të kuptojnë dhe të interpretojnë siç duhet historinë e Ungjillit në lidhje me Krishtin, atëherë ne duhet t'i pajisim ata me informacione dhe dëgjuesit tanë në lidhje me bazën kristologjike të Testamentit të Vjetër.

5. Gjatë evangjelizmit, dëgjuesve tanë duhet t'u shpjegohet historia themelore dhe kultura e Izraelit, sepse vetëm atëherë ata do të jenë në gjendje të kuptojnë historinë e Mesisë çifut, tipet shëlbyes të Testamentit të Vjetër që u përmbushën tek Krishti, pozitën e Krishtit si Bir i Davidit, Mbret, dhe

Gjykatësin e Izraelit, shërbimin e Tij të veçantë për delet e humbura të Izraelit, dhe refuzimin përfundimtar që iu bë Atij nga populli i Tij.

Këto udhëzime të mësimdhënies biblike janë thelbësore në punën evangjeliste. Po si të sigurohesha unë që të gjitha këto aspekte të domosdoshme do të përfshiheshin në programin tim mësimdhënës evangjelist? Ku do të gjeja formatin mësimdhënës ku të përfshiheshin parimet e mësimdhënies biblike?

Duke studiuar çdo parim më vete arrita në përfundimin se mënyra më e mirë për të predikuar Ungjillin është të fillosh nga fillimi dhe t'i shpjegosh Shkrimet e Shenjta në mënyrë kronologjike për t'u siguruar që njerëzit e kuptojnë historinë e Krishtit dhe janë të përgatitur për Ungjillin.

Pjesa e parë e Skicës së Mësimdhënies Kronologjike, që flet për evangjelizmin dhe e vë theksin mbi **shpëtimin**, fillon me Gjenezën dhe përfundon me ngritjen e Krishtit, siç regjistrohet në librin e Akteve. Të pesëdhjetë mësimet në këtë kurs, Themele të forta—Krijimi sipas Krishtit, trajtojnë këtë pjesë evangjelistike të skicës së mësimdhënies kronologjike.

Testamenti i Vjetër na jep zbuluesen themelore të Perëndisë si Krijuesi sovran i njeriut, i gjithëfuqishëm, i gjithëditur, i shenjtë, i dashur, i drejtë, i mëshirshëm, dhe i pandryshueshëm, si Gjykatësi, Ligjvënës dhe Shpëtimtari i njeriut. Kjo zbuluesë e Perëndisë fillon tek Gjenezja 1 dhe vazhdon gjatë gjithë zhvillimit historik të racës njerëzore dhe gjatë jetës së patriarkëve, duke filluar me Abrahamin. Zbulimi i natyrës dhe i karakterit të Perëndisë tregohet tek gjykimi që Ai i bëri faraonit dhe Egjiptit, çlirimi i Izraelit nga skllavëria, dhe kujdesin e Perëndisë për izraelitët gjatë marshimit të tyre në shkretëtirë për në Malin Sinai. Pozita sovrane e Perëndisë si Krijuesi i njeriut, si Ligjvënës, si Gjykatës përforcohet në mënyrë serioze duke na dhënë Ligjin e shkruar. Shpalosja e natyrës dhe karakterit të Perëndisë vazhdon me anë të gjykimeve të Tij mbi izraelitët, të karakterizuara nga mëshira e Tij dhe nga kujdesi i tij vigjilent dhe i vazhdueshëm. Nëpërmjet shërbesave të Moisiut, Joshuas, gjykatësve, mbretërve dhe profetëve, Perëndia manifestoi qartë që është e drejtë e Tij të dënojë fajtorin dhe të falë të penduarin.

Testamenti i Vjetër trajton organizimin e Ligjit. Kjo nuk do të thotë që hiri i Perëndisë nuk u shfaq gjatë periudhës së Testamentit të Vjetër. Shpëtimi i mëkatarëve, duke filluar nga Adami dhe Eva, gjithmonë ka qenë nëpërmjet hirit të Perëndisë. Por edhe pse hiri i Perëndisë është i dukshëm në Testamentin e Vjetër, përsëri sovraniteti, drejtësia, shenjtëria dhe

gjykimi i Perëndisë dalin në pah më qartë. Nëpërmjet Ligjit që iu dha Izraelit, Perëndia e zbuloi veten e Tij si i Shenjti që nuk do ta falë mëkatin dhe nuk do ta lerë pa e dënuar. Ligji i Perëndisë u dha gjatë periudhës së Testamentit të Vjetër për të shfaqur mangësinë e lindur të zemrës njerëzore si dhe inatin e shenjtë të Perëndisë kundër të gjithë atyre që thyejnë urdhëresat e Tij. Prandaj, nuk ka rrugë tjetër më të drejtë për ta ballafaquar të pashpëtuarin me kërkesat e Ligjit të shenjtë të Perëndisë sesa t'i tregosh atyre që nuk janë të shpëtuar pjesët e Testamentit të Vjetër ku Perëndia përdor Ligjin për t'i mësuar dhe për t'i përgatitur izraelitët që të kuptojnë dhe të shohin gjendjen e tyre të pashpresë dhe nevojën për Shpëtimtarin.

Por a është e nevojshme t'u mësosh njerëzve të pashpëtuar të gjitha pjesët e Testamentit të Vjetër përpara se t'u shpjegosh veprën shpëtuese të Krishtit? Jo! Është e panevojshme, sepse pjesa më e madhe e Testamentit të Vjetër dhe të Ri i adresohet besimtarëve. Qëllimi kryesor i Ungjillit, nga ana tjetër, ishte që t'u mësonte njerëzve të pashpëtuar jetën e Krishtit dhe veprën e Tij shëlbyese. Gjoni ka thënë për Ungjillin e tij, *“këto janë shkruar, që ju të besoni që Jezusi është Krishti, Biri i Perëndisë; dhe që të besoni që ju mund të keni jetë nëpërmjet emrit të tij.”* (Gjoni 20:31). Prej këtij, rrjedh logjikisht se në punën evangjelizuese, ne duhet të shpjegojmë ato pjesët të Testamentit të Vjetër që janë themelet për historinë e Krishtit që nga lindja e Tij deri tek ngritja e Tij. Duhet të jepen pjesë të mjaftueshme nga Testamenti i Vjetër, në mënyrë që kur të përdoren të dhëna gjeografike dhe historike, profeci, personalitete dhe ilustrime nga shkruarit e Ungjillit, atëherë dëgjuesit të jenë në dijeni për këtë histori dhe në këtë mënyrë do ta kuptojnë më qartë kuptimin dhe arsyen përse këto përdoren.

## Duke ndjekur rrjedhën e historisë biblike

Meqë Perëndia ka vendosur që ta zbulojë veten e Tij në kuadrin e historisë, atëherë Shkrimet e Shenjta do të shpjegohen më qartë nëse ndjekim rrjedhën e historisë nga Gjenezja deri tek Zbulesa.

Skica e Mësimdhënies Kronologjike bazohet në pjesët historike të librave të Biblës që regjistrojnë lëvizjen përpara të historisë. Skema në faqen që vijon ilustron rrjedhën e historisë biblike.

## Kërkohet shumë kohë për t'u mësuar njerëzve

Një nga ankesat më të rëndomta në lidhje me formën e mësimdhënies që sugjerohet në këtë libër është që kërkohet një kohë e gjatë për t'ua mësuar njerëzve.

### Rrjedha e Historisë Biblike

Librat e Lëvizjes Historike	Libra të Tjerë të Shkruar Gjatë Këtyre Periudhave
Gjeneza	Jobi, Psallmet
Eksodi	Levitikus, Psallmet
Numrat	Deuteronomia, Psallmet
Joshua	Psallmet
Gjykatësit	Ruthi, Psallmet
I dhe II Samueli	Psallmet
I dhe II Mbretërit	Proverbat, Ekleziastët, Kënga e Solomonit, I Kronikat, II Kronikat, Isaia, Joeli, Amosi, Obadiah, Jonah, Mikah, Nahum, Habakkuk, Zefaniah, Psallmet
Danieli	Jeremiah, Vajet, Ezekiel
Ezra	Hagai, Zakariah
Nehemiah	Ester
Malaki	
Mateu, Marku, Luka, Gjoni	
Aktet	Jakobi, I dhe II Selanikasit, Galacianët, I dhe II Korintasit, Romakët, Filemoni, Efizianët, Kolosianët, Filipianët, I Pjetri, I Timoteu, Titusi, II Timoteu, Hebrejtë, II Pjetri, Juda, I, II dhe III Gjoni
Zbulesa	

Ne jetojmë në kohët kur njerëzit kërkojnë t'i bëjnë punët në mënyrën më të shpejtë dhe më të lehtë. Gjellë të paragatuara të ngrira, ëmëlsira të shpejta, furra me mikrovalë na ndihmojnë që ta kemi çdo gjë në pak minuta në tavolinë. Sot gjenden shumë mjete për të shpejtuar procesin e jetës së përditshme.

E njëjta mënyrë të menduari ka hyrë edhe në Kishën e Krishterë, dhe shpeshherë zbatohet edhe në fushën e evangjelizimit, të rritjes së kishës, dhe në çdo fushë tjetër të jetës kishtare.

Të krishterët duhet të mësojnë rrugë më efikase në punën e tyre, por në të njëjtën kohë ata nuk duhet të harrojnë se fuqia e Perëndisë manifestohet dhe vepra e Tij kryhet duke shpallur të vërtetën e Perëndisë në fuqinë e Frymës së Shenjtë. Nuk ka rrugë tjetër. Perëndia nuk e ndryshon metodën e Tij për t'iu përshtatur mendimit modern dhe të ashtuquajturave përparime. “...Unë jam ZOTI, Unë nuk ndryshoj...” (Malaki 3:6). Kjo është e vërtetë për natyrën e Perëndisë, por nuk është e vërtetë për mënyrat e Tij të punës.

Nevoja më e madhe e njeriut është të dëgjojë, të kuptojë dhe t'i përgjigjet Fjalës së pastër të Perëndisë. Fuqia e Perëndisë është e pranishme në Fjalën e Perëndisë. Ishte pikërisht Fjala e Perëndisë me anë të së cilës Perëndia i Gjithëfuqishëm solli rendin në këtë kaos, solli dritën në këtë errësi, dhe jetën në këtë botë të pajetë. Dhe është Fjala e Tij me anë të së cilës Zoti zbulon ligësinë e zemrës njerëzore, i sjell jetë shpirtit të vdekur të njeriut, çliron robërit e Satanit, dhe i jep dritë nga ana shpirtërore të verbërit (Isaia 55:10,11; Luka 4:18; Gjoni 8:32; I Pjetri 1:23-25).

Përgjegjësia e të krishterit është t'u mësojë njerëzve Fjalën e Perëndisë duke u mbështetur totalisht në Frymën e Shenjtë. Nuk është mençuria njerëzore, dhe as metodat e vërteta evangjelistike ato që mund të shpejtojnë punën e Frymës së Shenjtë dhe konvertimin e shpirtit. Është përgjegjësia jonë për të përcaktuar ose provuar të detyrojmë kohën e lindjes së re. Ne duhet të shpjegojmë me besim gjithçka që na është besuar dhe t'ia lëmë Zotit punën e transformimit.

Një nga të metat më të mëdha në shërbimin e Kishës në mbarë botën është mospronimi nga Kisha për të harxhuar një kohë të gjatë për t'u mësuar njerëzve të pashpëtuar dhe t'ia lënë Perëndisë Frymën e Shenjtë që të bëjë punën e ndriçimit, të bindjes dhe t'u japë njerëzve atë tip besimi tek Jezus Krishti që do t'i bëjë njerëzit t'i thonë Palit të sigurt, "...Unë e di se kujt i kam besuar, dhe jam i bindur që ai është në gjendje ta ruajë visarin tim deri në atë ditë." (II TImoteu 1:12). Jack Douglas, misionar në fisin Pawaia në Papa Niu Gini, dha këtë koment, "T'i mësosh njerëzit që nga Gjenezja harxhoi një kohë të gjatë dhe shumë përpjekje, por ia vlente. Pawaianët tani e dinë se çfarë besojnë dhe përse e besojnë."

Shumica e programeve të dëshimit bëjnë të mundur ballafaqimin e kristianëve në takime të shkurtëra me njerëzit e pashpëtuar. Nuk bëhen përpjekje të mjaftueshme për të përgatitur jo-të krishterët që të kuptojnë arsyet e vërteta të besimit ose kuptimin e Ungjillit. Zakonisht, disa vargje si p.sh. Romakët 3:23, u citohen njerëzve të pashpëtuar dhe personi detyrohet të marrë vendimin e tij për Krishtin.

Shkrimet e Shenjta e bëjnë të qartë se njerit i jepet përgjigjësia të mbjellë farën, tjetrit ta ujitë dhe një tjetri ta mbledhë frutin (Gjoni 4:36-38; I Korintasit 3:6,7). Në pjesën më të madhe të metodave evangjeliste, personi që e mbjell farën kërkon ta korrë atë menjëherë. Vërtet që Zoti nuk është i kufizuar. Fjala e Tij ka fuqi të madhe shpëtuese, dhe shpeshherë Ai përdor të njëjtin njeri për të mbjellë e

për të korrur. Por përgjegjësia jonë është që të sigurohemi që po predikojmë me besnikëri gjithçka që Ai na i ka thënë në Fjalën e Tij që njerëzit të përgatiten në mënyrë biblike për Ungjillin. Atëherë ne mund t'i besojmë Atij që të forcojë edhe më shumë.

Programet e dëshimit më të efektshëm janë ato që i lejojnë të krishterët të shpjegojnë Fjalën e Perëndisë në mënyrë dhe që të mbështeten tek Frymën e Shenjtë për të bërë punën e Tij në kohën e duhur. Fëmijët e Perëndisë duhet të njihen me njerëzit e pashpëtuar, të ngrejnë studime të Biblës në shtëpitë e tyre dhe t'u mësojnë atyre vazhdimisht, bile edhe me javë dhe muaj të tërë, ato gjëra që Perëndia i ka regjistruar në Fjalën e Tij si themele për Ungjillin.

### Tregojua Ungjillin atyre që janë të përgatitur

Tashmë unë i kam dhënë arsyet përse duhet t'u shpjegohet njerëzve të pashpëtuar struktura themelore e Testamentit të Vjetër përpara se t'u mësohet atyre historia e Krishtit dhe Ungjilli siç regjistrohen në Testamentin e Ri. Por nuk duhet të mendohet që unë po sugjeroj që askush nuk mund të shpëtohet në qoftë se ai njeri nuk e ka dëgjuar ose kuptuar Skicën e Testamentit të Vjetër të paraqitur në këtë program mësimdhëniesje. Unë as nuk po them që mësuesi nuk duhet t'ia japë Ungjillin atij që është i përgatitur për Ungjillin derisa atij t'i jetë shpjeguar skema e propozuar. Ne nuk duhet të kufizohemi nga një skemë, por ne duhet të udhëhiqemi nga parimet biblike të cilat shpjegohen qartë gjatë gjithë Fjalës së Perëndisë.

Në qoftë se gjatë shpjegimit të Skicës së Testamentit të Vjetër, ndonjë individ në një grup njerëzit ndriçohet shpirtërisht përpara Perëndisë, mësuesi duhet të përcaktojë se kur t'i japë mëkatari të zgjuar mësimë private të mëtejshme mbi lindjen, jetën, vdekjen dhe ringjalljen e Zotit Jezus Krisht. Ashtu siç është gabim që t'u detyrosh Ungjillin atyre që nuk janë të përgatitur për Perëndinë, po ashtu është gabim të mos ua japësh Ungjillin atyre që tashmë janë të mësuar nga Perëndia, që janë të thyer në shpirt, dhe që janë të etur për mëshirën dhe faljen e Shpëtimtarit. Pa dyshim, disa njerëz do të arrijnë të kuptojnë dhe do të përgatiten mirë nga Frymën e Shenjtë për të pranuar Ungjillin përpara se të fillojnë shpjegimin e Ungjillit. Kur u ndesha me një situatë të tillë, unë e veçova këtë individ nga grupi dhe e pyeta me kujdes nëse ai i kishte kuptuar siç duhet të vërtetat themelore në lidhje me Perëndinë, shenjtërinë e Tij, urrejtjen dhe gjykimin e Tij mbi mëkat, dhe gjendjen e pashpësë mëkatare të njeriut përpara Perëndisë. Duke qenë i bindur që ky njeri e kishte të qartë dhe po e pranonte Fjalën e Perëndisë, atëherë

me kujdes i fola për planin e plotë të Perëndisë për mëkatarët nëpërmjet lindjes së shenjtë, jetës, vdekjes së flijuar, varrimit dhe ringjalljen e Krishtit. Nëse një njeri përgatitet vërtet nga Perëndia, besimi tek Krishti do të jetë rezultati për të dëgjuar dhe kuptuar Ungjillin (Gjoni 6:44,45).

Një i ri palavano me emrin Kamlon po i ndiqte mbledhjet ku unë po shpjegoja Shkrimet e Shenjta në mënyrë kronologjike për rreth tre muaj. Një ditë Kamlon erdhi tek mua dhe tha, “Do të filloj t’i lutem Perëndisë tënde.” Unë nuk lutesha me palavanët gjatë periudhave të mësimin, por ata e dinin që katolikët romakë luteshin, dhe ata na kishin parë që ne falenderonim Perëndinë për ushqimin në shtëpitë tona.

Unë e pyeta, “A mendon se duke u lutur do të arrish Perëndinë? A e mban mend se si Perëndia e nxori Adamin dhe Evën nga kopshti dhe vuri çerubimët atje me shpatën flakëruese. A mund ta heqë shpatën që vuri Perëndia lutja që do të bësh ti? A mund t’i fuste ata përsëri në kopsht bisedimi me Perëndinë?”

Ai u përgjigj, “Jo, nuk mund t’i fuste përsëri në kopsht.”

Unë e pyeta, “Atëherë përse mendon ti se duke u lutur ti do të jesh në gjendje të vish tek Perëndia? Cili është dënimi për mëkatin?”

Ai u përgjigj, “Vdekja.”

Ne sapo e kishim shpjeguar historinë e dhënies së Ligjit në mbledhjen e grupit tonë. Kështu që ne folëm për historitë e Testamentit të Vjetër që ilustronë që vdekja është gjykimin i drejtë i Perëndisë mbi mëkatin.

Unë thashë, “Perëndia kërkon vdekjen dhe ky është një çmim i fiksuar.” Ky term “çmim i fiksuar” u përdor gjatë shpjegimit tonë dhe është termi që përdoret nga filipinët kur tregtarët duan të thonë që për këtë artikull nuk mund të bësh pazar. Në disa dyqane të mëdha, kur një njeri fillon të bëjë pazar, shitësi shpeshherë do t’i thotë, “na vjen keq por është çmim i fiksuar.” Ata nuk do të bëjnë pazar sepse të gjithë artikujt e tyre kanë një çmim të caktuar. Kështu që unë i thashë Kamlonit, “Çmimi i Perëndisë është i fiksuar. Perëndia kërkon vdekjen. Lutja nuk është çmimi që kërkon Perëndia. Ai nuk do të pranojë asgjë tjetër veç vdekjes, që do të thotë ndarje nga Perëndia.”

Kamloni vazhdoi të vinte në mbledhje për ditë; por një javë më vonë ai erdhi tek unë dhe bisedoi me mua. “Kalang Kayu” ishin fjalët që m’u drejtua mua.

(Këto fjalë do të thonë “Pemë e Madhe”, që ishte emri që më ishte vënë nga komuniteti fisnor nga që isha më i gjatë në shtat së të gjithë ata.) “Tani e kuptoj,” tha Kamloni, “që lutja nuk do të më kthejë mua tek Perëndia. Por çfarë të bëj? E di prej Fjalës së Perëndisë që jam mëkatar. Për këtë jam shumë i sigurtë. E di që do të shkoj në Ferr. Çfarë të bëj?”

Duke lëvdur Perëndinë në zemrën time për ato që Fryma e Shenjtë i kishte mësuar këtij njeriu, u përgjigja, “Kamlon, ti më ka pyetur se çfarë mund të bësh. Më thuaj, cili është çmimi që duhet paguar?”

Ai u përgjigj, “Vdekja.”

Unë i thashë, “Kamlon, nëse ti dëshiron të paguash për mëkatin tënd, atëherë ti duhet të shkosh në Ferr. Dënimi për mëkatin tënd nuk merr kurrë fund.”

Ai qëndroi atje me një pamje shumë të mjerueshme, dhe më në fund tha, “Atëherë, unë do të shkoj në Ferr.”

Menjëherë, unë mendova, Jo, ti nuk do të shkosh. Unë e dija që Kamlonin po e mësonte Perëndia. Nëpërmjet Shkrimeve të Shenjta të Testamentit të Vjetër, ai kishte parë të vërtetat themelore për Perëndinë, për veten e tij dhe për mëkatin e tij. Ai tani ishte i përgatitur të kuptonte Ungjillin dhe t’i besonte vetëm Krishtit për shpëtim.

“Kamlon,” i thashë, “Eja dhe të ulemi në verandë.” Ne u ngjitën në verandë dhe u ulëm atje. Pastaj unë e pyeta, “A të kujtohet se si në kopsht, mbasi njeriu mëkatoi, Perëndia premtoi se do të dërgonte Një që do të ishte femija e një virgjëreshe? Perëndia premtoi se Ai do të shkatërronte Satanin që deri në atë kohë e kishte vënë njeriun nën pushtetin e tij.”

Ai u përgjigj, “Po, më kujtohet.”

Unë përsërita edhe një herë historitë kryesore të Testamentit të Vjetër në të cilat tregohet Shpëtimtari që po vinte. Atëherë, mbi bazën e këtyre historive të Testamentit të Vjetër dhe premtimeve të Perëndisë në lidhje me Krishtin, i thashë, “Kamlon, Shpëtimtari ka ardhur tashmë.”

Gjatë orës tjetër, i fola shkurtimisht për historinë e Jezus Krishtit. Kur më në fund erdha në momentin kur Krishti vdiq në vendin tonë, i thashë Kamlonit, “Perëndia e dinte që ti do të lindje. Perëndia e dinte që ti do të ishe mëkatar. Perëndia e dinte që ti do të meritoje dënimin e përjetshëm për shkak të mëkatin tënd. Dhe Perëndia e dinte që ti nuk do të shpëtoje nëse nuk do të paguhej plotësisht

borxhi i mëkatit. Zoti Jezus, ngaqë e donte shumë njeriun, pranoi të zinte vendin tonë dhe të merrte përsipër të shlyente të gjithë mëkatin tonë.”

Kur fola për vdekjen e Krishtit në kryq, Kamloni tha me një buzëqeshje në fytyrë, “Atëherë nëse Ai ka vdekur për mua, mua nuk më duhet të vdes. Ai ma ka paguar borxhin.”

Pikërisht atëherë, shpirti i tij mbështetej në të vërtetën e Shkrimeve të Shenjta. Ai i besoi Krishtit si “paguesi i borxhit” të tij. Ai e pranoi faktin se atë që ai nuk mund ta bënte dot vetë, e kishte bërë Perëndia për të.

Dennis dhe Jeanie O’Keefe që janë misionarë në fisin Molbog në Filipinet e Jugut ka shkruar këto gjëra për një djalosh të komuniteti fisnor të cilit Dennis i ka mësuar Shkrimet e Shenjta në mënyrë kronologjike.

“Pothuajse çdo ditë, ose duke ardhur ose duke shkruar tek fushat e tij të orizit, Saya do të kthehej tek zyra ime për një kafe, dhe ne do të bisedonim. Ato kohë ishin të çmueshme. Ai po kuptonte të vërtetën biblike reale. Nga biseda me të dilte që po e kuptonte se nuk do të ishte në gjendje të përmbushte kërkesat e Perëndisë dhe do të dënohej në përjetësi për mëkatin dhe natyrën e tij.

“Mbasi dhashë mësimë edhe në fshatra të tjera, tani kishte ardhur koha të vazhdoja me Sayan. Kështu që një ditë, Saya dhe unë shkuaam nga tabernakulli tek Kryqi. Ç’kënaqësi! Të gjitha të panjohurat u puthitën tek një njeri Jezus Krishti. Ai u habit. Ndërsa mendja e tij po shkonte që nga Gjeneza 3:15 tek Gjoni 19:30, ‘Ka përfunduar...’, ne u ulëm të heshtur për disa minuta. Pastaj ai tha, Mos do të thuash që Ai mori përsipër mëkatet e mia?”

“Këtë e ka bërë Perëndia, dhe për ne kjo është një gjë shumë e bukur. Ne të gjithë gëzohemi në horizontet e reja, që na janë hapur nga hiri i Perëndisë të demonstruar në këtë njeri të vetëm.”

### **Takime të shkurtëra**

Besoj se del e qartë gjatë gjithë këtij libri që unë kam parasysh situata ku njerëzve mund t’u shërbesh për periudha të konsiderueshme kohe. Kjo është e mundur në një punë misionare të mirë-programuar, në shkollat e të djelave, në klasat e Biblës, dhe në shërbesën e kishës lokale. Por si duhet të veprohet kur kemi vetëm një kohë të shkurtër për të predikuar?

Megjithëse ne nuk duhet të kufizohemi nga një skemë mësimdhënieje, megjithatë ne duhet gjith-

monë të udhëhiqemi, bile edhe në takime të shkurtëra, nga parime biblike. Një parim shumë i qartë të cilin ne e kemi diskutuar tashmë, është se vetëm ata të përgatitur dhe të tërhequr nga Perëndia Fryma e Shenjtë mund të vijnë tek Krishti. Perëndia nuk bën ato gjëra që Ai vetë na porosit të mos i bëjmë. Ai nuk “hedh perla para derave”.

Ne nuk duhet ta datyrujmë me forcë Ungjillin njerëzve që nuk janë të përgatitur. Por ka një dallim të madh midis deklaratës së përgjithshme publike të veprës historike të Perëndisë tek Krishti për tërë botën dhe aplikimit personal të asaj vepre tek individë të veçantë. Një predikues në një takim publik, që flet me një grup të përzier njerëzish, zemrat e të cilëve ai nuk dhe nuk mund t’i dinte, mund të ketë liri të plotë të paraqesë Ungjillin dhe të gjitha ofertat plot hir të Perëndisë për mëkatarët pendues. Por edhe në këtë rast, ai gjithmonë ai duhet të jetë në dijeni se vetëm ata që kanë pranuar mëkatin dhe janë të përlulur nga Perëndia nëpërmjet Fjalës së Tij dhe veprës së Frymës së Shenjtë do ta besojnë dhe do ta vlerësojnë mesazhin e shpëtimit të Ungjillit. Ata që nuk i pranojnë themelet e Ungjillit—d.m.th. karakterin e shenjtë dhe të drejtë por të mëshirshëm të Perëndisë, dhe gjendjen e humbur, mëkatore dhe të pashpresë të njeriut—nuk mund të besojë në veprën historike shpëtuese të Perëndisë Biri dhe të lindet nga Fryma. Prandaj, edhe në mbledhjet publike për Ungjillin ku folësi mund të mos ketë mundësi t’u predikojë po atyre njerëzve përsëri, atëherë predikuesi duhet të theksojë natyrën dhe karakterin e Perëndisë dhe kërkesat e Ligjit të shenjtë dhe të drejtë të Perëndisë përpara se të ofrohet lajmi i mirë i Ungjillit të Perëndisë.

Në librin e Akteve, kur Pali hyn në një sinagogë çifutësh, ai më parë u kujtoi dëgjuesve të tyre historinë themelore të Testamentit të Vjetër ku Perëndia zbulon veten e Tij dhe premtimet e Tij në lidhje me ardhjen e Shpëtimtarit. Mbasi bën këtë, Pali atëherë paraqet pretendimet e Jezusit nga Nazareti për të qenë Mesia i premtuar kohë më përpara dhe tregoi që vdekja e Krishtit dhe ringjallja e Tij e vërtetuan Atë si Shpëtimtarin e caktuar të Perëndisë për të gjitha ata që besojnë. Aty për aty u vu re një ndarje midis dëgjuesve të Palit. Ata që ishin të përgatitur kishin dëshirë të dëgjonin më shumë; ndërsa ata me zemra të fortësuara dhe me besim në vetvete nuk e pranuan mesazhin e tij. Ata që u përgjigjën u veçuan dhe atyre iu shpjegua më shumë nga Apostulli, në mënyrë që besimi i tyre të mbështetet mbi një ekspozim të qartë të Shkrimeve të Shenjta të Testamentit të Vjetër në dritën e zbulesës së re tek Krishti.

Në situata të tjera kur kristianët kanë vetëm një mundësi të vogël për t'i dëshmuar një individ—në tren, autobus, aeroplan, në një dyqan, në rrugë, në shtëpi—duhet të ndiqen sa më shumë të jetë e mundur të njëjta parime biblike në atë kohë të kufizuar. Në vend të shërbesave të shpejta “ma le ta lash” në takime të shkurtra, kristianët duhet të përqihen të bien në kontakt me njerëzit dhe të ndjekin një metodë mësimdhënieje të vazhdueshme, mundësisht në kurse studimi të Biblës. Nëse kjo është e pamundur, atëherë mund të përdoret literaturë e përshtatshme që do t'i bëjë ata nëpërmjet Shkrimeve të Shenjta të kenë dijeni më të plotë për Krishtin.

Në një zonë ku ne punuam si misionarë në Palavano, ishte një grua magjistare. I shoqi i saj ishte shumë i sëmurë dhe nuk ishte më në gjendje të ecte. Ai qëndronte shtrirë në shtrojën e tij ditë e natë.

Unë kaloja pothuajse përditë nga ajo rrugë ku i jepja mësim një të lebrosurit që ishte i vëllai i plakës magjistare. Në fillim, ndalova që t'i përsëndes, e të pyesja për shëndetin e të sëmurit, dhe t'i pyesja nëse mund të ndihmonin në një farë mënyre. Në fillim, ata kundërshtuan që ne t'i jepnim ndihmë mjeksore, por mbas një farë kohe, nuk thanë gjë. Me këtë rast, unë qëndrova pak më gjatë duke pasur rast që t'u paraqes Biblën si Fjala e Perëndisë dhe t'u flas për Perëndinë, si i vetmi qenie supreme e përjetshme. Shumë shpejt mbas kësaj, ata dërguan fjalët me nipin e tyre se ata nuk donin të dëgjonin më për Perëndinë. Mbas këtij incidenti, ata as që nuk na dilnin përpara. Antagonizmi i tyre me ne dhe me mesazhin tonë ishte i qartë në të gjithë sjelljen e tyre.

Zakoni palavano për një njeri të martuar kërkonte që ai të largohej nga shtëpia e tij dhe të shkonte e të jetonte me të shoqen e tij në lokalitetin e gruas së tij. Por nëse ai është shumë i sëmurë ose nëse e di që nuk do të jetojë gjatë, ai do të kërkojë që ta kthejnë përsëri tek njerëzit e tij pranë shtëpisë së tij. Kur burri i magjstares e kuptoi se po vdiste, atë e çuan në shtëpinë e kushërinjve të tij.

Më vonë, ne u çuditëm shumë kur disa nga kushërinjtë e tij ecën tre orë më këmbë për të më kërkuar mua që të shkoja e t'i flisja njeriut që po vdiste për Perëndinë. Kjo dëshmi sigurisht që ishte punë e Perëndisë në jetën e tij.

Duke u gëzuar që ndoshta fara e vogël e mbjellë në mendjen e tij kishte qenë përdorur nga Fryma e Shenjtë, shkova menjëherë me kushërinjtë e tij në shtëpinë ku ishte ai. Ai ishte gati duke vdekur, por

akoma ishte në gjendje të pëshpëriste përgjigje të shkurtra për pyetjet e mia.

Duke u ulur pranë tij, u përkula mbi të dhe fillova t'i shpjegoj, “Ato që do të të them nuk janë fjalët e mia ose mendimet e njerëzve, por fjalët e Perëndisë së gjallë të vërtetë dhe të vetëm.”

Nga brenda, nuk jam ndjerë kaq i pashpresë se atë ditë. Po i lutesha Zotit të më jepta mençuri dhe qartësi dhe t'i jepte të sëmurit që po vdiste mundësi të kuptonte, të bindej dhe të pendohej me besim.

Unë vazhdova, “Perëndia na thotë në librin e Tij se Ai i krijoi të gjitha gjërat.” Dhe më vonë shtova, “Perëndia e krijoi njeriun e parë, Adamin, që ishte babai i gjithë racës njerëzore.” Unë desha që ky njeri të kuptonte që këtu përfshiheshin edhe palavanët dhe për pasojë edhe ai.

Plaku dukej sikur po më dëgjonte ndërsa unë vazhdova, “Perëndia e vuri Adamin në një kopsht të bukur. Në këtë kopsht ai mbolli dy pemë shumë të rëndësishme, Pemën e Jetës dhe Pemën e Dijes së të Mirës dhe të Keqes”. Mbas i shpjegova me terma shumë të thjeshtë kuptimin e këtyre dy pemëve, i thashë, “Perëndia e paralajmëroi Adamin se mosbindja do t'i sillte vdekjen. Vdekja jo vetëm që do të sillte vdekjen fizike por edhe ndarjen e përjetshme nga Perëndia në një vend dënimi.”

Në këtë moment, unë sugjerova që ai të pushonte dhe të mendonte për ato që i thashë. Kjo gjithashtu më dha mua një mundësi për t'u shpjeguar edhe kushërinjve të tij që ishin mbledhur në atë shtëpi.

Duke u kthyer nga ai mbas një farë kohe, e pyeta nëse i kishte kuptuar ato që i thashë deri tani. Ai më siguroi se i kishte kuptuar, kështu që nga Gjeneza 3, unë i thashë tundimin dhe rënien e njeriut. Pastaj i shpjegova Gjenezën 3:15, “Perëndia premtoi që një ditë Ai do të sillte një Shpëtimtar i cili do të shkatërronte Satanin dhe do të çlironte njeriun nga pushteti i tij. Perëndia e nxori Adamin dhe Evën jashtë kopshtit. Ata mbetën jashtë, larg Perëndisë, pa asnjë mundësi për t'u kthyer, vetëm nëse Perëndia do të gjente një mënyrë që ata të ktheheshin përsëri.”

Pastaj i tregova historinë e Kainit dhe Abelit këtij njeriu të sëmurë. Theksova, “Të dy si Kaini dhe Abeli kishin lindur jashtë kopshtit dhe ishin mëkatarë për shkak të atit të tyre, Adamit. Ata ishin të ndarë nga Perëndia dhe nuk mund t'i shpëtonin dot gjykimin të Perëndisë për mëkatin, vetëm nëse Perëndia do të bënte diçka që t'i shpëtonte ata.”

Plaku lëvizi pak nga vendi që të kapte çdo fjalë timen. Unë vazhdova, “Këto të vërteta janë për të gjithë njerëzit, dhe ajo që është e rëndësishme, ato janë edhe për ty. Sepse edhe ti je pasardhës i Adamit, edhe ti ka lindur larg Perëndisë, i ndarë nga Pema e Jetës.”

Pushova pak dhe pastaj i shpjegova se si Perëndia e udhëzoi njeriun që, nëse ai do të donte të vinte tek Perëndia, ai duhet të merrte qengjin dhe ta therrte atë. Unë theksova, Ata duhet të vinin tek Perëndia sipas mënyrës që kishte porositur Perëndia. Ata duhet ta therrnin qengjin. Gjaku i tij duhej të derdhej. Tani, gjaku i kafshëve nuk mund të paguajë për mëkatet tona. Por gjaku duhej të derdhej që t’u kujtonte njerëzve që ata meritonin të vdisnin dhe që vetëm Perëndia mund t’i shpëtonte ata. Besimi i tyre duhej të ishte vetëm tek Perëndia, dhe jo në veten e tyre ose në ndonjë gjë tjetër që mund të bënin ata.”

Pastaj unë u thashë shkurtimisht historinë se si Kaini nuk pranoi të vinte tek Perëndia sipas mënyrës së Perëndisë dhe për këtë arsye u refuzua nga Perëndia, ndërsa Abeli erdhi sipas rrugës që kishte porositur Perëndia, duke besuar në mëshirën e Perëndisë dhe në premtimet e Tij, kështu që u pranua nga Perëndia. Mbasi vura këtë themel, pastaj fillova t’i zbatoj të gjitha këto të vërteta tek dëgjuesi im.

“Nuk ka asnjë rrugë që të shpëtosh. Mëkati tënd duhet të shlyhet duke u ndarë përjetë nga Perëndia. Ai nuk do të pranojë gjë tjetër. Vetëm Perëndia mund të më shpëtojë mua. Ashtu si Abeli, edhe ju duhet të pranoni rrugën që ndoqi Abeli nëse dëshironi të shpëtoni.”

“Po paralajmërohesh. Mos u bë si Kaini dhe të mendosh se mund të vish tek Perëndia sips rrugës tënde.”

Plaku po vështronte i menduar thellë, dhe unë i thashë, “Po të lë të mendohesh për ato që të thashë, dhe pastaj do të tregoj ato që ka bërë Perëndia në mënyrë që mëkatet e tua të falen dhe ti të shpëtosh nga dënimi që meriton.”

Duke u kthyer përsëri tek ai mbas pak, e pyeta, dhe ai e pranoi, “Po, unë jam mëkatar” Ai pastaj pyeti, Më thuaj çfarë ka bërë Perëndia për mua.”

Zemra m’u mbush me gëzim, duke shpalosur në fjalët më të thjeshta historinë e Ungjillit.

“Perëndia dërgoi Birin e Tij të vetëm në këtë botë që të ishte Shpëtimtari ynë. Krishti lindi nga një grua e virgjër, ashtu siç kishte premtuar

Perëndia. Ai bëri një jetë të përsosur. Shumica e njerëzve nuk e pranuan Atë dhe e kryqëzuan. Ai mund t’i shkatërronte ata dhe të rikthehej përsëri në Parajsë, por Ai i lejoi ata që ta gozhdonin në kryq në mënyrë që Ai të paguante për dënimin për të gjithë mëkatet e njerëzimit.”

I kujtova këtij plaku që ishte kaq afër mallkimit të përjetshëm, “Dënimi i Perëndisë për mëkatin është ndarje e përjetshme prej Tij në vendin e dënimit të tmerrshëm.”

Pastaj i thashë, “Kur Jezusi po vdiste në Kryq, Ai thirri, ‘O Perëndia ime, Perëndia ime, përse më ke braktisur?’ Përse mendoni ju se e braktisi Perëndia Zotin Jezus? Zoti Jezus u braktis dhe vdiq që të ishte Shpëtimtari i mëkatarëve. Zoti Jezus vdiq për ty që të zinte vendin tënd në mënyrë që Perëndia të mund t’i falte të gjitha mëkatet tuaja dhe t’ju jepte jetën e amshuar.”

Citova Gjonin 3:16 dhe i tregova atij historinë e ringjalljes.

Duke u ulur pranë tij dhe duke e vështruar në fytyrë ku po afrohej vdekja, i thashë, “Zoti Jezus mund të të shohë ty që tani, mu aty ku je shtrirë në këtë shtrojë. Po t’i besosh atij dhe të pranosh atë që Ai pagoi në kryq për mëkatin tënd, Perëndia do të të falë për të gjitha mëkatet tuaja.”

Duke vazhduar në zërin tim u vu re një shenjë urgjence, “Po ta pranosh Atë, ti nuk do të shkosh në vendin e dënimit të përjetshëm, por në Parajsë ku do të jesh me Perëndinë.”

“Mos u bë si Kaini” e luta. “Mos mendo se ti do të vish tek Perëndia sipas mënyrës tënde. Mëkati tënd duhet të shlyhet, dhe ka vetëm një çmim që e pranon Perëndia; dhe ai është çmimi që pagoi Zoti Jezus Krisht kur Ai u braktis nga Perëndia për mëkatet tuaja.”

I thashë, “A e kupton? A do të më bësh ndonjë pyetje?”

Me një pëshpëritje të mekur, ai m’u përgjegj, “Po, e kuptoj.” Ai dukej se ishte duke menduar thellë ndërsa mbylli sytë.

Duke ecur nëpër xhungël për të shkuar në shtëpinë time nëpër errësirë, zemra ime po i lutej Zotit që me mëshirën e Tij ta shpëtonte këtë njeri.

Mbas pak, ne na vizituan disa nga kushërinjtë e atij plaku, që na thanë se plaku i sëmurë kishte vdekur në të gdhirë mbas vizitës sime. Por përpara se të vdiste, ai u tha atyre që t’i thoshin Pemës së

Madhe (emri im fisnor) që nuk kisha pse të shqetësohesha se tani ai po i besonte Zotit Jezus që kishte marrë dënimin për mëkatet e tij. Lavdi Zotit për mëshirën e Tij të madhe dhe për thjeshtësinë e Ungjillit!

Situatat ndryshojnë shumë. Ngandonjëherë ne nuk mund të kemi kohën e mjaftueshme ashtu si kisha unë me plakun që po vdiste. Ne duhet të bëjmë çfarëdo që të mundemi brenda kohës që na ka dhënë Zoti që ta bëjmë Fjalën e Perëndisë që qartë dhe të thjeshtë dhe të besojmë që Zoti përdor të gjitha ato që themi ne në takimet e shkurtëra. Por sa herë që të jetë e mundur, është përgjegjësia jonë që të shpjegojmë në mënyrë të atillë që njerëzit ta kuptojnë pse duhet të vijnë tek Krishti dhe që të besojnë vetëm tek Ai dhe në vdekjen e Tij në emër të tyre.

### **Evangjelizmi për grupet e përziera—jobsimtarët dhe besimtarët**

Shumë grupe dhe kisha, si ato që ne predikua fillimisht në Palavano, nuk e kanë të qartë rrugën e shpëtimit. Faza evangjeliste e Skicës së Mësimdhënies Kronologjike është përdorur në mënyrë të efektshme për t'i mësuar kisha dhe grupe të tilla. Shumë individë, të cilët më parë mendonin se ishin fëmijët e Perëndisë, e kanë kuptuar gjendjen e tyre të vërtetë nëpërmjet zbulësës së shenjtërisë së Perëndisë të regjistruar në Testamentin e Vjetër, kërkesat e Tij për përsosmëri siç zbulohet nëpërmjet Ligjit, dhe gjykimet e Tij të tmerrshme mbi mëkatat rebelues. Pastaj nëpërmjet historisë së Ungjillit, ata kanë parë për herë të parë se ata kanë nevojë për veprën e shpëtimit, sepse Krishti i ka siguruar të gjitha ato që Perëndia kërkon me të drejtë.

Do të dëshiroja që t'i kisha të qarta këto kur fillova të predikoj në fillim në kishat fisnore të palavanëve. U përpoqa të kthelloj mendjet e tyre duke u shpjeguar më parë shfajësimin sipas temave dhe pastaj nga Letrat romakëve edhe pse ata nuk kishin themele të shëndosha nga Testamenti i Vjetër. Me gjithë vështirësitë që ndeshja gjatë shpjegimit të mësimit dhe në vështirësitë që edhe ata ndeshën për ta kuptuar, shumë anëtarë të kishave palavane u ndriçuan shpirtërisht duke e kuptuar gjendjen e tyre të humbur dhe arritën t'i besonin Krishtit. Por imagjino se sa më i thjeshtë dhe më i qartë do të ishte procesi i mësimit nëse do të kisha filluar mësimdhënien në mënyrë kronologjike nëpër Testamentin e Vjetër si një fazë përgatitore për Ungjillin e hirit të zbuluar në Testamentin e Ri!

Disa vite më vonë, mbasi i kisha kuptuar gabimet e mia dhe kisha filluar shpjegimin e Shkrimeve të Shenjta në mënyrë kronologjike në një zonë tjetër në

Palavano, u ktheva përsëri në zonën ku kisha qenë fillimisht për të shpjeguar kronologjikisht nga Gjenezja deri tek ngritja lart e Krishtit. Mbasi u shpjegova për një farë kohe, disa nga pleqtë e kishës erdhën dhe më pyetën, “Përse nuk na e shpjegove në këtë mënyrë që në fillim? Kjo mënyrë shpjegimi e bën çdo gjë më të qartë!” Tani ata mund ta shikonin se si çdo gjë që kishin mësuar nga Testamenti i Ri përputhej me Testamentin e Vjetër në një të tërë të plotë. Unë rashë dakord me mendimin e tyre, sepse për mua ishte e qartë se atyre që ua kisha shpjeguar Shkrimet e Shenjta në mënyrë kronologjike e kishin kuptuar më mirë Ungjillin se sa atyre të cilëve ua kisha shpjeguar Testamentin e Ri sipas temave dhe në mënyrë ekspozicionale.

Materiali që vijon u shkrua nga Tim Cain dhe Larry Richardson, në lidhje me indianët Puinave në Kolombi.

“Kur shkuam në Puinave, ne vajtëm me mendimin se atje kishte një kishë të Testamentit të Ri, të cilës i mungonte një metodë e mirë mësimdhënieje. Por sa më shumë kuptonin gjuhën dhe njerëzit, aq më shumë po e kuptonin se atje kishte disa probleme të vërteta. Ne arritëm në përfundimin se pjesa më e madhe e Puinave që e quanin veten “të krishterë”, në të vërtetë ishin shpirtërisht të vdekur. Ja disa nga gjërat që vumë re atje:

- A. “Pleqtë e kishës” përpiqeshin që t'i detyronin të rinjtë që të pranonin ‘krishterimin’. Krishterimi për ta do të thoshte (1) mos pi duhan dhe alkool, (2) të ndjekësh mbledhjet përditë, (3) të shkosh nëpër konferencat, (4) të dëshmosh që ke disa mëkate dhe që tani e tutje do të jetosh pa mëkate dhe (5) të pagëzohesh.
- B. Njerëzit nuk e kishin shumë të qartë Fjalën e Perëndisë. Ata dinin disa histori nga Testamenti i Vjetër dhe pak më shumë nga Testamenti i Ri, por ata nuk kishin asnjë ide për kronologjinë e historive dhe rëndësinë e tyre.
- C. Nuk kishte asnjë rritje nga ana shpirtërore.
- D. Njerëzit vazhdonin të praktikonin magjitë. Magjistarët u mallkuan, por jo metodat e tyre.
- E. Vdekja e Jezusit u dukej si diçka shtesë që Perëndia e mendoj si të nevojshme.

“Ne filluam të vrisnim mendjen, duke menduar se nga ta fillojmë predikimin tonë, dhe vendosëm që

ta fillojmë nga fillimi. Metoda Kronologjike ishte një frymëzim dhe një ndihmë e madhe për ne.

Ndërsa unë (Timi) fillova të predikoj, u kërkova të falur për konfuzionin që kishim krijuar duke mos e filluar nga fillimi, dhe u premtova që këtë rradhë do të bëja çmos që t'ua shpjegoja siç duhet.

Ne u shpjeguan deri tek ngritja lart e Krishtit, dhe gjatë gjithë kohës, njerëzit treguan interes të madh. Por asgjë nuk ndodhi.

S'kishe ç'të bëje veç ta filloje edhe një herë nga e para.

Herën e tretë, ata filluan të tregojnë se e kishin kuptuar dhe pranuar.

Alberto, një nga drejtuesit e fshatit, më tha që ai kishte qenë shumë afër Ferrit. Ai më tha se ai "kishte luajtur kishash" për tridhjetë vjet dhe që pagëzimi i tij ishte 'thjesht një banjë. Por tani, ai e kuptonte se, për të qenë në marrëdhënie të drejta me Perëndinë, nuk kishte rëndësi ato që kishin bërë ata por ato që kishte bërë Jezusi për ata.

Një plak nga komuniteti fisnor, në fund të njërit nga sesionet tona të mësimit, u ngrit për të dëshmuar. Duke qëndruar atje më këmbë në mes të gjithë atij konfuzioni dhe zhurme, ai tha, 'Më në fund po e kuptoj. Unë jam një mëkatar shumë i keq, por Jezusi pagoi çmimin për mëkatin tim me vdekjen e tij.' Njerëzit përreth tij u përpoqën që ta detyronin që të ulej, por ai tha, 'Jo, dua që ta them këtë!' Ai dha një dëshmi shumë të qartë.

Një tjetër njeri, që ishte dhjakon në një nga kishat Puinave, gjithashtu dëshmoi, 'Deri tani, gjithmonë kam menduar se Perëndia do të pranonte për të gjitha ato që kam bërë për Të. Jam

pagëzuar. Ndihmova që të grumbulloheshin njerëzit nëpër mbledhjet. Kam mbledhur shumë ushqime që t'i prisnim të ftuarit nëpër konferenca sa më mirë. Gjithmonë kam marrë pjesë në mbledhjet për lutjet para se të gdhihet. Jam i sigurtë që ato janë gjërat që Perëndia pa në zemrën time, sepse ato janë gjërat që unë po i ofroja Perëndisë për të qenë në gjendje t'i afrohesha Atij. Por tani e kuptoj se ato gjëra janë tamam si dhuratat që Kaini i ofroi Perëndisë, kështu që ato i kam zëvendësuar me gjakun e Krishtit. Kjo është ajo sheh tani Perëndia në zemrën time. Kjo është ajo që po i ofroj unë Perëndisë tani, ashtu si Abeli që flijoi kafshën shumë kohë më parë.

Në një tjetër konferencë me indianët, ne po shpjegonim pjesën e parë të kronologjisë së Biblës. Alberto, i cili kishte qenë besimtar për një vit e ca, po ndihmonte gjatë mësimit, dhe në të njëjtën kohë ai po përkthente në Kuripaco për ata që nuk e kuptonin gjuhën Puinave. Ai dhe unë e ndjenim që ky grup i veçantë nuk ishte i përgatitur për të zbatuar ato që kishim shpjeguar për shpëtimin. Prandaj, ne e mbyllëm mbledhjen e fundit duke i inkurajuar dëgjuesit të mendojnë me kujdes për ato që u thamë dhe të pyesin veten e tyre se çfarë mund t'i ofrojnë Perëndisë. Papritur, bile unë as që e vura re, një grua plakë u ngrit dhe filloi të fliste në gjuhën Kuripaco. Për një moment e kuptova se diçka po ndodhte dhe prita që të ma shpjegonin. Alberto m'u kthye dhe më tha, 'Ajo grua plakë thotë që e ka gjetur atë që do t'i ofrojë Perëndisë—gjakun e Jezus Krishtit, që Ai derdhi në kryq. Kjo është ajo që do t'i ofrojë ajo Perëndisë.'

Këtyre njerëzve u ishte shpjeguar Fjala në mënyrë tematike nga misionarët e tjerë dhe për shumë vite kishin lexuar nga Testamenti i Ri, kështu që për ta nuk ishte në asnjë mënyrë takimi i parë me kristianizmin."